Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË RADIO TELEVIZIONIT TË KOSOVËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Radio Televizionit të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin "Baza për Opinion të Kundërt", Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të Radio Televizionit të Kosovës deri me 31 dhjetor 2021, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2021, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

A1 Radio Televizioni i Kosovës, gjatë vitit 2021 në pasqyra financiare ka njohur të hyra të realizuara përmes kontratave të kompensimit (këmbime jo monetare) nga departamenti i marketingut në vlerë 500,792€, duke mos matur vlerën e drejtë të këtyre transaksioneve sipas kërkesave të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 15.

A2 Prej dhjetë (10) konfirmimeve të dërguara tek furnitorët, në katër (4) raste nuk kemi pranuar konfirmimet e saldove nga furnitorët në vlerë 389,322€. Prandaj, në mungesë të konfirmimeve, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri të arsyeshme nëse vlera bartëse e llogarive të pagueshmeve tregtare të RTK-së e prezantuar në pasqyra financiare ishte e saktë.

A3 Produksionet e jashtme dhe të brendshme të cilat ishin kontraktuar nga RTK në vlerë prej 384,373€ nuk ishin njohur si pasuri e paprekshme, siç ishte vepruar me produksionet e tjera të ngjashme, por ato ishin njohur vetëm si shpenzime. Ky trajtim jo adekuat i tyre ka nënvlerësuar zërin e pasurive të paprekshme në pasqyrën e pozicionit financiar të RTK-së, si dhe ka mbivlerësuar shpenzimet e periudhës në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vlerën e lartshënuar.

A4 Saldo e zërit "Të drejtat e programit" në pasqyrën e pozicionit financiar është prezantuar me vlerë prej 323,745€ tek pasuria, por ne kemi vërejtur se kjo shumë ishte nënvlerësuar për vlerën 20,713€, ndërsa ishin mbivlerësuar shpenzimet e periudhës në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për të njëjten vlerë.

A5 Në vitin 2021, RTK kishte paguar shujta për punonjësit e saj në vlerë 164,285€, pa e konfirmuar prezencën e tyre në punë. Pagesat si të tilla janë të parregullta.

A6 RTK nuk kishte paraqitur në mënyrë të plotë obligimet ndaj Telekomit të Kosovës, por kishte aplikuar metodën e thyerjes së saldove (të kërkesave me detyrime) mes saj dhe Telekomit. Kjo kishte reflektuar në nënvlerësim të llogarive të pagueshme tregtare në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 186,033€ si dhe tek pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme për vlerën e lartshënuar.

A7 RTK-ja për tetë (8) raste të të punësuarve me pagesë vjetore prej 64,630€ përveç kontratave të tyre, nuk kishte dëshmi për vijueshmërinë se të njëjtit kanë punuar gjatë vitit 2021.

A8 Prej 12 konfirmimeve të dërguara tek debitorët për llogaritë e arkëtueshme, në tetë (8) raste nuk kemi pranuar konfirmimet e saldove në vlerë 212,793€. Prandaj, në mungesë të tyre, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri të arsyeshme nëse vlera bartëse të llogarive të arkëtueshme tregtare të RTK-së e prezantuar në pasqyra financiare ishte e saktë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Institucioneve të pavarura publike të cilat raportojnë në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Radio Televizionit të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A9 RTK në vitin 2021 kishte paguar vlerën prej 10,455€ për shtesa dhe shpërblime për punonjësit e saj, përkundër rekomandimit të Bordit me datën 22.01.2019 për ndalimin e pagesës për shtesa dhe shpërblime.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Institucioneve të pavarura publike të cilat raportojnë në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjet tjera të zbatueshme nga ana e RTK-së.

Bordi i RTK-së është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Radio Televizionit të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Radio Televizionit të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Radio Televizionit të Kosovës në përputhje me të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme për RTK-në.[2]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe

konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet qe të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Radio Televizioni i Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Radio Televizionit të Kosovës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Radio Televizionit të Kosovës, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që RTK të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet te shënimet shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 17 rekomandime të reja. Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Trajtimi i të hyrave jo në pajtim me Standardin e Raportimit Financiar

Gjetja

Paragrafi 66 i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar - SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët", citon se; "Për të përcaktuar çmimin e transaksionit për kontrata në të cilat klienti premton një shumë korresponduese në një formë tjetër nga mjetet monetare, njësia ekonomike do të masë shumën korresponduese jo në mjete monetare (ose shumën korresponduese të premtuar jo në mjete monetare) sipas vlerës së drejtë." Kërkesa e SNRF 15 që gjatë trajtimit të transaksioneve jo monetare të këmbimit, entiteti të matë vlerën e drejtë të tyre, në të kundërtën këto transaksione nuk gjejnë zbatim.

RTK gjatë vitit 2021, kishte njohur të hyrat nga marketingu në vlerë 1,114,064€. Prej tyre, të hyra nga kompensimet (këmbimet jo monetare) ishin njohur 500,792€ apo 44% e totalit të të hyrave nga marketingu. Për këtë kategori të hyrash, ne kemi testuar 16 mostra në vlerë 131,525€, për të cilat RTK kishte vazhduar të lidhë kontrata kompensimi me operatorët ekonomik për të marrë mallra apo shërbime kundrejt hapësirës reklamuese. Kompensimi ishte bërë direkt me ofruesit e shërbimeve pa pranuar oferta të tjera. Në këto transaksione parimi i vlerës së drejtë nuk ishte zbatuar nga RTK.

Sipas menaxhmentit kjo formë e kontraktimit të mallrave dhe shërbimeve ishte aplikuar qysh prej themelimit të RTK-së si dhe në mungesë të njohurive se këto transaksione janë specifikuar më shumë nga SNRF-të e reja, nuk janë aplikuar kërkesat e standardit.

Ndikimi

Njohja apo matja e të hyrave pa respektuar parimin e vlerës së drejtë si kërkesë e SNRF 15, ka bërë që paraqitja e pasqyrave financiare të mos jetë e saktë dhe e drejtë. Si rezultat i kësaj është mbi vlerësuar zëri i të hyrave dhe shpenzimeve në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, duke pasur efekt të përhapur edhe tek fitimet e bartura në pasqyrën e pozicionit financiar, në pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, e po ashtu edhe në pasqyrën e ndryshimit në ekuitet. Njëherit, kjo ka ndikuar në gabime materiale të përhapura në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A1

Bordi i RTK-së të sigurojë se të gjitha transaksionet të cilat kryen gjatë periudhës kontabël të trajtohen sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), në mënyrë që raportimi financiar të jetë i drejtë dhe në pajtim me kornizën raportuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mungesa e konfirmimeve nga palët e treta për llogaritë e pagueshme

Gjetja

Sipas Kornizës Konceptuale për raportim financiar, paragrafi 4.26, një detyrim njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ka gjasa që burime ekonomike të dalin nga njësia ekonomike për të shlyer një detyrim aktual dhe shuma me të cilën do të shlyhet detyrimi mund të matet me besueshmëri.

Për të testuar saktësinë e llogarive të pagueshme tregtare, përveç procedurave tjera, ne kemi dërguar dhjetë (10) konfirmime tek palët e treta apo furnitorët me vlerë të përbashkët prej 925,864€.

Deri në përfundim të auditimit, ne kemi pranuar vetëm gjashtë konfirmime nga furnitorët për vlerën 536,542€, ndërsa për katër (4) furnitorë me vlerë totale të saldove 389,322€, nuk kemi pranuar konfirmimet e kërkuara. Në mungesë të këtyre konfirmimeve, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri të arsyeshme nëse vlera bartëse e llogarive të pagueshmeve tregtare e prezantuar në pasqyra financiare ishte e saktë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos aplikimit të harmonizimeve në baza periodike dhe komunikimit jo të mjaftueshëm të RTK-së me furnitorët e saj.

Ndikimi

Mos harmonizimi periodik i të dhënave të RTK-së dhe furnitorëve ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së llogarive në pasqyra financiare.

Rekomandimi A2

Bordi i RTK-së duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin vjetor të gjendjes së llogarive mes RTK-së dhe furnitorëve, duke mos i përjashtuar edhe dërgesat fizike të konfirmimeve nga zyrtarët e RTK-së dhe vizitave te furnitorët për ta konfirmuar gjendjen përfundimtare të detyrimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Aplikim i politikave të pa qarta për vlerësimet kontabël

Gjetja

Standardi Ndërkombëtar të Kontabilitetit 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet" respektivisht paragrafi 13, citon se "Një njësi ekonomike zgjedhë dhe zbaton politikat e sajë kontabël me qëndrueshmëri për transaksione, ngjarje dhe kushte të tjera të ngjashme, përveç rastit kur një Standard apo një Interpretim kërkon apo lejon në mënyrë të posaçme kategorizimin e elementëve për të cilët politika të ndryshme mund të jenë të përshtatshme. Nëse një Standard ose një Interpretim kërkon ose lejon kategorizim të tillë, zgjidhet dhe zbatohet një politikë kontabël me qëndrueshmëri për çdo kategori".

Gjatë auditimit ne kemi konstatuar se zërat kontabël të njëjtë ishin trajtuar në mënyra të ndryshme nga ana e RTK-së.

Produksionet e jashtme të natyrës së njëjtë nuk ishin njohur, regjistruar dhe prezantuar në PVF në mënyrë të drejtë, por ato janë trajtuar në mënyra të ndryshme nga RTK-ja. Fjala është për rastet:

- Emisioni "Sekrete kuzhine" me vlerë totale të kontratës prej 80,000€, ishte njohur si pasuri e paprekshme, ndërsa Emisioni "Kosova Prodhon" me vlerë të kontratës prej 60,000€ ishte njohur si shpenzim i periudhës;
- Më tej, seriali "Çka ka shpija" ishte njohur si pasuri e paprekshme, ndërsa seriali tjetër" Byfeja e Parlamentit "me kosto vjetore prej 165,373€ ishte njohur si shpenzim i periudhës;
- Po ashtu, edhe filmi "Pranverë e pa harruar në fshatin e harruar" me kosto 5,000€, apo seriali "Vendlindja ime" me kosto 154,000€ ishin njohur si shpenzime të periudhës.

Këto produksione të jashtme apo të brendshme të cilat ishin kontraktuar nga RTK-ja nuk ishin njohur si pasuri e paprekshme, siç kishte ndodhur me produksionet tjera të ngjajshme, por ishin njohur vetëm si shpenzime të periudhës, duke nënvlerësuar pasurinë e paprekshme dhe duke i mbi vlerësuar shpenzimet.

Edhe pse RTK-ja ka një numër të rregulloreve të brendshme, ende nuk ka politika të qarta të gjykimeve dhe vlerësimeve kontabël për kategorinë e pasurive të paprekshme.

Kjo kishte ndodhur për arsye se zyrtarët e RTK-së kishin vlerësuar se këto produksione nuk kanë potencial për të gjeneruar të ardhura për RTK-në dhe duhet të njihen si shpenzime, e jo si pasuri e paprekshme.

Ndikimi

Në mungesë të këtyre politikave të vlerësimeve te qëndrueshme nga RTK-ja, është e mundur që produksionet që kanë vlera afatgjata e që duhet trajtuar si pasuri, të trajtohen si shpenzime. Apo e kundërta, produksionet që nuk kanë vlera afatgjata dhe nuk gjenerojnë të ardhura për organizatën, të trajtohen pasuri të pa prekshme.

Rekomandimi A3

Bordi i RTK-së të sigurojë se janë marrë veprime konkrete për përcaktimin e politikave të qarta të vlerësimeve kontabël, sidomos të pasurive të paprekshme. Sugjerojmë se me rastin e vlerësimeve që një produksion të trajtohet si pasuri apo të njihet si shpenzim i periudhës, RTK të formojë një juri kompetente e cila do ta vlerësonte cilësinë, vlerën e produksionit dhe jetëgjatësinë e tij, dhe varësisht nga këto vlerësime, të bëj edhe regjistrimet kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Nënvlerësimi i investimeve në vijim/të drejtat e programit

Gjetja

Paragrafi 1.17 i Kornizës Konceptuale për Raportimin Financiar, parasheh që " Kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara përshkruan efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera dhe rrethanave mbi burimet dhe kërkesat shtesë të një njësie raportuese në periudhat në të cilat këto efekte ndodhin, edhe nëse arkëtimet dhe pagesat përkatëse të mjeteve monetare ndodhin në një periudhë të ndryshme. Kjo është e rëndësishme për shkak se informacioni në lidhje me burimet dhe kërkesat shtesë ekonomike të një njësie raportuese dhe ndryshimet në burimet dhe kërkesat shtesë ekonomike të saj gjatë periudhës ofron një bazë të mirë për të vlerësuar performancën e kaluar dhe të ardhshme të njësisë ekonomike sesa vetëm informacioni rreth arkëtimeve dhe pagesave në mjete monetare gjatë kësaj periudhe".

Saldo e zërit Investime në vijim/të drejtat e programit në PFV është prezantuar me vlerë prej 323,745€, mirëpo, gjatë analizave tona kemi konstatuar se kjo shumë ishte nënvlerësuar për vlerën 20,713€, për projektet si në vijim:

- Te projekti "Sekrete Kuzhine" saldo në fund të vitit ishte njohur zero €, ndërsa duhej të ishte 10,000€";
- Te projekti "Filma të Huaj" saldo në fund të vitit ishte 27,295€, ndërsa duhej të ishte 29,508€";
- Te projekti "FiFa World Coup", ndeshjet kualifikuese Conmebol saldo në fund të vitit ishte 25,500€, ndërsa duhej të ishte 34,000€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se RTK-ja nuk kishte verifikuar të gjitha transaksionet e ndodhura deri në datën raportuese.

Ndikimi

Mos harmonizimi i duhur i transaksioneve të ndodhura deri në datën raportuese ka ndikuar në paraqitjen jo të drejtë të Investimeve në vijim/ të drejtat e programit në PFV.

Rekomandimi A4

Bordi i RTK-së duhet të siguroj se para përgatitjes së pasqyrave financiare, të gjitha transaksionet të cilat kanë ndodhur janë paraqitur drejtë dhe saktë në periudhën e duhur kontabël. Po ashtu, menaxherët e kontratave deri në datën raportuese duhet të ofrojnë shënimet e sakta për shkallën e përmbushjes së kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mbi pagesa për shujtë

Gjetja

Paragrafi 1 i nenit 58 i Marrëveshjes Kolektive të RTK-së, përcakton se "Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës me orar të plotë për ditët e pranisë në punë dhe vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2.5€".

Gjatë analizave tona, ne kemi vërejtur se RTK kishte paguar shujta në vlerë prej 164,285€, për persona të cilët nuk kishin qenë fare në punë. Pra, pagesa e shujtës ishte bërë pa konfirmimin e prezencës së tyre në punë.

Sipas RTK-së, pagesa e shujtave kishte ndodhur në kohën e pandemisë me ç'rast ishte krijuar një situatë ku nuk mund të evidentohej prezenca e punonjësve në punë.

Ndikimi

Mungesa e kontrolleve efektive të brendshme lidhur me vijueshmërinë e stafit në punë sjellë rrezikun e pagesave të parregullta pa ndonjë bazë të qartë ligjore të cilat e ngarkojnë buxhetin e RTK-së për shpenzime që nuk duhet paguar.

Rekomandimi A5

Bordi i RTK-së duhet të siguroj se pagesat për shujta iu bëhen vetëm personave të cilëve u takon ky kompensim sipas rregulloreve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Kompensimi i llogarive në mes RTK dhe Telekomit të Kosovës

Gjetja

Paragrafët Nr. 32 dhe 33 të SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare përcaktojnë se: • Aktivet dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet nuk duhet të kompensohen me përjashtim të rastit kur kjo gjë kërkohet ose lejohet nga një SNRF (par.32); dhe • Është e rëndësishme që aktivet dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të raportohen më vete. Kompensimi në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse ose pozicionin financiar ose në pasqyrën e të ardhurave individuale (nëse paraqitet), me përjashtim të rastit kur kompensimi reflekton thelbin e transaksionit ose një ngjarjeje tjetër, pakëson aftësinë e përdoruesve për të kuptuar transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera që kanë ndodhur dhe për të vlerësuar flukset e ardhshme monetare të njësisë ekonomike (par.33).

Më datë 24.12.2019 ishte lidhur një marrëveshje mes RTK-së dhe Telekomit të Kosovës për harmonizimin e gjendjes së llogarive, të borxheve dhe kërkesave nga palët në marrëveshje.

Me këtë marrëveshje dy palët ishin dakorduar që:

- Obligimet e RTK-së ndaj Telekomit të Kosovës për faturat e shpenzimeve për shërbimet e telefonisë të thyhen apo kompensohen me obligimet të cilat i ka Telekomi i Kosovës ndaj RTK-së për pagesën e shfrytëzimit të antenave.

- Ky kompensim kishte nxjerrë një obligim neto të RTK-së ndaj Telekomit të Kosovës në vlerë prej 85,982€, me të drejtën e shfrytëzimit të hapësirës reklamuese nga Telekomi i Kosovës.

Meqenëse këto transaksione nuk janë paraqitur si të plota në raportimin e PVF-ve, por është përdorur metoda e saldove neto, për këtë arsye zëri i llogarive të pagueshme tregtare është nënvlerësuar për shumën 186,033€ në pasqyrat financiare.

Kjo kishte ndodhur për shkak zyrtarët financiar nuk kishin njohuri se këto lloj marrëveshjesh nuk janë të përshtatshme dhe nuk janë në pajtim me standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Ndikimi Paraqitja e transaksioneve në mënyrë jo të përshtatshme ndikon në zvogëlimin e llogarive pa pasur hyrje dhe dalje të parasë, Kjo vështirëson dhe ndikon edhe raportimin jo të drejtë të PFV-ve, si dhe nuk mundëson pamjen e qartë të rrjedhës së parasë.

Rekomandimi A6 Bordi i RTK-së të sigurojë se në të ardhmen nuk do të ndiqen praktika të tilla dhe të merren veprime korrigjuese, në mënyrë që prezantimi i informacionit financiar të jetë i plotë dhe konform standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mungesë evidencash për vijueshmërinë e stafit në punë

Gjetja Marrëdhënia e punës në RTK rregullohet me Ligjin e punës. Paragrafi 2 i nenit 20 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 përcakton se: "Orari i plotë i punës zgjat dyzetë (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe".

RTK posedon sistem elektronik të evidentimit ditor të ardhje/vajtjes, dhe ne kemi testuar gjerësisht këtë sistem. Gjetjet janë si vijon:

- Gjithsej 15 punonjës nuk janë evidentuar në punë nga 10 deri në 12 muaj të vitit. Prej tyre, në shtatë (7) raste kemi pranuar konfirmime alternative nga mbikëqyrësit e tyre se ata kanë punuar gjatë gjithë vitit. Ndërsa, për tetë (8) rastet tjera ne nuk kemi pranuar asnjë dëshmi se ata kanë punuar gjatë vitit. Kostoja e pagave bruto për këta tetë punonjës është 64,630€, shumë të cilën RTK e ka paguar për vitin 2021;
- Nga gjithsej 763 punonjës të rregullt të RTK-së, 126 prej tyre nuk kanë poseduar kartelë elektronike për evidentimin e tyre në punë pasi për arsye të ndryshme kishin humbur kartelat e evidentimit dhe se RTK nuk kishte prodhuar kartela të tjera rezervë për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore;
- Vendimi me numër 2501/16 i datës 15.08.2016 i marrë nga ana e

Drejtorit të Përgjithshëm ka liruar nga evidentimi ditor 58 persona kryesisht udhëheqës të ndryshëm, menaxher të njësive të ndryshme, kryeredaktorë dhe menaxhmentin e lartë. Ky vendim nuk kishte bazë juridike, ndërsa është mbështetur në një konkluzion të mbledhjes së menaxhmentit, të cilën RTK nuk ka mundur të na siguroj. RTK, të vetmin instrument për evidentim në punë që e posedon është sistemi elektronik i vijueshmërisë, ndërsa për personat që i ka liruar nga evidentimi, nuk posedon një mekanizëm tjetër që dokumenton vijueshmërinë e tyre në punë.

Kjo gjendje është krijuar si rezultat i vendimeve jo të duhura nga ana e menaxhmentit dhe mungesës së kontrolleve të brendshme gjatë vitit.

Ndikimi Kontrollet e dobëta në evidentimin e të punësuarve për vajtje-ardhje në punë dhe nxjerrja e vendimeve pa ndonjë bazë të qartë juridike, mund të shkaktoj pagesa të parregullta dhe dëmtim buxheti, si dhe të dekurajojë pjesën tjetër të stafit e cila vijon punën në baza të rregullta.

Rekomandimi A7 Bordi i RTK-së duhet të sigurojë se menaxhmenti nxjerrë vendime në harmoni me rregullativën ligjore. Po ashtu, duhet të vendos kontrolle më efektive për vijueshmërinë e gjithë stafit, si dhe të pajisë gjithë stafin me kartela, për të bërë të mundur evidentimin e vijueshmërisë së tyre në punë apo mbajtjen e evidencave në forma tjera.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mungesa e konfirmimeve nga palët e treta për llogaritë e arkëtueshme

Gjetja Sipas SNK 1 një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, ose në pasqyrën e pozicionit financiar ose në shënimet shpjeguese, për nën klasifikime të mëtejshme të zërave të paraqitur, të klasifikuar në një mënyrë të përshtatshme për operacionet e njësisë ekonomike. Të dhënat e kontabilitetit duhet të jenë burim i besueshëm për hartimin e pasqyrave financiare.

Për të testuar saktësinë e llogarive të arkëtueshme tregtare, përveç procedurave tjera, ne kemi dërguar dymbëdhjetë (12) konfirmime tek palët e treta/klientët në vlerë të përbashkët prej 312,431€, ndërsa prej tyre ne kemi pranuar vetëm katër konfirmime me vlerë prej 99,638€. Ne nuk kemi pranuar konfirmimet nga tetë (8) klientë në vlerë 212,793€, prandaj në mungesë të këtyre konfirmimeve të jashtme, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri të arsyeshme për vlerën bartëse të llogarive të arkëtueshmeve tregtare të RTK-së në pasqyra financiare.

Kjo kishte ndodhur për shkak se RTK nuk kishte bërë harmonizimet me kohë të kartelave në mes të klientëve dhe RTK-së.

Ndikimi	Mos harmonizimi vjetor i të dhënave të RTK-së dhe klientëve të saj shkakton pasiguri me gjendjes e llogarive nëse ato janë të sakta. Kjo, ndikon në keqdeklarimin e gjendjes së llogarive edhe në pasqyrat financiare.
Rekomandimi A8	Bordi i RTK-së duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin vjetor të gjendjes së llogarive mes RTK-së dhe debitorëve, duke mos i përjashtuar edhe dërgesat fizike të konfirmimeve nga zyrtarët e RTK-së dhe vizitave te debitorët për ta konfirmuar gjendjen përfundimtare të kërkesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A9 - Mos zbatimi i vendimit për ndalesat e shpërblimeve dhe shtesave

Gjetja

Kompetencat e Bordit janë rregulluar në nenin 29 të ligjit të RTK-së nr. 04/L-046. Paragrafi 2.9 i nenit 29 citon se "Bordi i RTK-së shqyrton dhe e miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe personelit tjetër, dhe siguron që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së, është dokument publik i cili pas shqyrtimit në Bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim."

Në procesverbalin e datës 22.01.2019, Bordi i RTK-së kishte rekomanduar Drejtorin e Përgjithshëm të bëjë pezullimin e pagesave për shpërblime, shtesa apo çdo formë tjetër të pagesës jashtë pagës mujore për të punësuarit në RTK, përveç rasteve të aprovuara nga ana e Bordit.

Nga auditimi kemi vërejtur se RTK edhe në vitin 2021 kishte paguar shtesa dhe shpërblime. Kosto e shpërblimeve dhe shtesave për këtë vit ishte 10,455€.

Sipas sqarimeve të RTK-së, këto shpërblime apo shtesa mbi pagë janë të përcaktuara në rregulloret e RTK-së si dhe i atribuohen detyrave specifike me të cilat ngarkohen punonjësit përtej punëve të tyre të rregullta.

Ndikimi

Mos zbatimi i vendimeve të Bordit të RTK-së nga menaxhmenti, rritë rrezikun e pagesave të parregullta dhe pa bazë ligjore.

Rekomandimi A9

Bordi i RTK-së duhet të siguroj se vendimet e tij janë duke u zbatuar nga menaxhmenti. Po ashtu, duhet të siguroj se për të gjitha pagesat për shpërblime apo shtesa të paguara jashtë vendimeve, rregullësia e tyre do të shqyrtohet nga ana e Departamentit Ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Kontrollet e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A10 - Mos dhënia e informacioneve shpjeguese për kontingjencat

Gjetja

Sipas SNK 37 – Provizionet, detyrimet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara, njësia ekonomike duhet të jap informacion shpjegues për pasuritë dhe detyrimet kontingjente (eventualitetet), përveç kur mundësia e një hyrje/dalje burimesh që përfshin përfitime/humbje ekonomike nuk ekziston më.

Shënimet shpjeguese në pasqyra nuk përmbajnë informacion për ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si detyrime dhe pasuri kontingjente.

Deri në datën raportuese të pasqyrave financiare, RTK kishte një numër prej 10 rastesh në gjykatë në të cilat ishte palë paditëse. Vlera e kontesteve të pretenduara nga RTK ishte vlerësuar 220,000€. Po ashtu, RTK kishte një numër prej 23 rastesh në gjykatë në të cilat ishte palë e paditur, vlera e kontesteve të pretenduara ndaj RTK-së ishte vlerësuar 3,325,532€.

Gjatë hartimit të pasqyrave financiare gjegjësisht rishikimit të tyre, menaxhmenti nuk kishte shpalosur këto çështje dhe nuk kishte bërë ndonjë vlerësim se sa mund të jetë ndikimi i tyre në rrjedhat e biznesit e as që kishte bërë ndonjë provizionim te tyre. Në mungesë të një vlerësimi nga ana e menaxhmentit, ne nuk ishim në gjendje të vlerësojmë shumën e tyre që do të duhej të njihej në datën raportuese si dhe efektin e tyre në pasqyra financiare.

Sipas shpejgimeve të ofruara, menaxhmenti ka vlerësuar se meqenëse nga zyra ligjore nuk kanë pasur ndonjë informacion më detaj, e kanë pasur të pamundur për të bërë një provizionim të këtyre kontingjencave.

Ndikimi

Në mungesë të këtyre vlerësimeve nga ana menaxhmentit, pasqyrat financiare nuk prezantojnë gjendje të drejtë të detyrimeve dhe kërkesave kontingjente nga të cilat pritet hyrje apo dalje e parasë në një të ardhme të afërt.

Rekomandimi A10

Bordi i RTK-së të sigurojë, se ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si detyrime kontingjente, të analizohen dhe vlerësohen në detaje në mënyrë që të njihen provizionet e këtyre llogarive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë afatgjata

Vlera neto e pasurive afatgjata e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 4,046,162€. Ato kanë të bëjnë kryesisht, ndërtesat, pajisjet dhe makineritë, inventarin, pajisjet dhe softuerin kompjuterik, pasuritë e paprekshme, etj. Në fushën e pasurive ne kemi ekzaminuar 70 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 2,521,455€ si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë. Përveç kësaj, sa i përket zhvlerësimit, ne kemi kryer procedurat analitike substanciale për popullacionin si tërësi.

Çështja A11 - Trajtim kontabël jo adekuat i investimit në vijim

Gjetja

Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 16 "Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)", kosto e një zëri të aktiveve afatgjata do të njihet si aktiv nëse dhe vetëm nëse:
a) është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe
b) kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

RTK në pasqyra financiare tek zëri i investime në vijim ka prezantuar vlerën prej 147,911€. Kjo vlerë në pasqyrat financiare vazhdon të prezantohet nga viti 2018, dhe lidhet me hartimin e planit ideor për ndërtimin e objektit të RTK-së, bazuar në planin rregullativ urban të komunës së Prishtinës si dhe ndarjes së parcelës. Kostoja e parashikuar e menaxhmentit të atëhershëm për ndërtimin e këtij objekti është mbi 30 milionë euro, dhe vlerësimi ishte se ky objekt mund të financohet ose nga Qeveria e Kosovës ose nga ndonjë donatorë potencial.

Për të vlerësuar mundësinë e realizueshmërisë së këtij projekti, ne kemi kërkuar nga menaxhmenti aktual një vlerësim të tyre në lidhje me gjasat që ky projekt të realizohet apo kur mund të fillojë ndërtimi i tij. Menaxhmenti nuk ka mundur të na ofroj ndonjë vlerësim se a mund të vazhdojë apo jo ky projekt, sepse mundësitë e financimit nga buxheti i RTK-së janë minimale, dhe se deri tani nuk është gjetur ndonjë donator i cili do të financonte këtë projekt me një kosto kaq të lartë.

Në mungesë të një vlerësimi nga menaxhmenti i cili do të qartësonte ecurinë e këtij projekti, dhe kërkesave të SNK 16, ne konsiderojmë se vlera e zërit të njohur si investim në vijim, nuk përmban kushtet të trajtohet si i tillë por duhej të njihej si shpenzim i periudhës.

Kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk ka mund të jap një vlerësim se a është i mundshëm realizimi i projektit, për arsye të kostos së lartë dhe pamundësisë së financimit vetiak.

Ndikimi

Njohja dhe paraqitja e zërave të caktuar pa i plotësuar kushtet sipas kërkesave të SNK-ve mund të ndikojë në prezantim jo të drejtë të pasqyrave

financiare.

Rekomandimi A11 Bordi i RTK-së të sigurojë se në pamundësi të realizimit të projektit, të bëhen vlerësimet dhe korrigjimet e nevojshme kontabël dhe trajtimi i duhur i këtij zëri në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A12 - Pronësia e pa definuar e pasurive /objekteve ku operon RTK

Gjetja Sipas Standardeve Ndërkombëtare SNKSP dhe Kornizës Konceptuale "Par. 5 BC 5.10 pronësia ligjore e një pasurie si një qasje në shërbime potenciale ose në përfitime ekonomike të një pasurie është një tregues i kontrollit. Megjithatë, të drejtat për shërbime potenciale ose aftësia për të gjeneruar përfitime ekonomike mund të ekzistojë pa pronësinë ligjore të pasurisë nëpërmjet mbajtjes dhe përdorimit të pronës.

Në Shënimet kontabël dhe raportin e regjistrimit të mjeteve themelore të fundvitit 2021, në regjistrin e pasurive nuk është prezantuar ndërtesa në të cilën operon RTK. Pra, përkundër faktit që ndërtesa e cila shfrytëzohet nga RTK ligjërisht nuk është pronë e RTK-së, ajo i sjellë përfitime organizatës dhe të paktën statusi i saj ishte dashtë të shpaloset në Pasqyrën e shënimeve shpjeguese.

Ndërtesa si e tillë, prej shumë vitesh shfrytëzohet nga ana e RTK-së pa asnjë dëshmi për të drejtën e shfrytëzimit. Sipas diskutimeve me zyrtarët e RTK-së, objekti është dhënë në shfrytëzim nga AKP, mirëpo nuk është ofruar ndonjë dëshmi që dokumenton se prona dhe ndërtesa në fjalë është në menaxhim të AKP-së dhe i është dhënë në shfrytëzim RTK-së, dhe për çfarë periudhe kohore është dhënë kjo e drejtë e shfrytëzimit.

Sipas shpjegimeve të menaxhmentit meqenëse objekti nuk ishte pronë e RTK-së, nuk ishte regjistruar si pasuri në librat kontabël.

Ndikimi Edhe pse objekti nuk ishte pronë legale e RTK-së, RTK ka pasur kontrollin e plotë për këtë objekt, dhe nga shfrytëzimi i saj ka nxjerrë përfitime të larta ekonomike. Prandaj, mos shpalosja e pasurive të cilat janë në shfrytëzim dhe sjellin përfitime për RTK-në, mund të ndikoj në paraqitjen jo të saktë dhe të drejtë të pasurisë afatgjatë në pasqyra financiare, por edhe gjendjes së përgjithshme të RTK-së.

Rekomandimi A12 Bordi i RTK-së duhet të merr masa të menjëhershme dhe çështjen e këtij objekti ta diskutojë me Kuvendin e Kosovës dhe AKP-në në mënyrë që të sqarohet pronësia e përhershme apo dhënia në shfrytëzim për kohë të caktuar, dhe më pas, çështja të trajtohet edhe në aspektin kontabël të regjistrimit të saj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A13 - Ndarje jo e duhur e detyrave në proceset e prokurimit dhe mos respektim i kërkesave teknike dhe profesionale të operatorëve

Gjetja

Ligji i Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, neni 69 Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 2.1 citon "listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çertifikatës (çertifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë. Po ashtu, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për prokurim publik, neni 62 Ndarja e detyrave, pika 4 përcakton: "Një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose TER, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura, nuk mund të nënshkruajë për asnjë nga artikujt e mësipërm 1 ose 2, as nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit".

Nga auditimi i pesë mostrave të blerjes se pasurive përmes procedurave te prokurimit, kemi vërejtur se:

Tek përgatitja e njoftimit për kontratë për procedurën e prokurimit për blerjen e ENG kamera me të gjitha pajisjet përcjellëse në vlerë prej 5,922€, tek kushtet për pjesëmarrje III2.4 AK ka kërkuar vetëm listën e furnizimeve në tri vitet e fundit, por nuk ka kërkuar edhe listë të referencave, siç e parasheh ligji. Po ashtu, për këtë kontratë ishte caktuar personi i njëjtë edhe si hartues i specifikimeve, edhe si menaxher i kontratës.

Tek njoftimi për kontratë për procedurën e prokurimit Karriga për stafin e RTK-së në vlerë prej 12,606€, kushtet për pjesëmarrje, III2.3 RTK ka kërkuar për dëshmi "Deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në ATK duke dëshmuar se OE gjatë tri (3) viteve të fundit ka pasur qarkullim vjetor jo më të vogël se 30,000€", kurse sipas dëshmive të operatorit fitues ai ka dorëzuar vetëm qarkullimin bankar vetëm për vitin 2020. Po ashtu, për këtë kontratë është i caktuar personi i njëjtë si hartues i specifikimeve dhe si anëtar i komisionit vlerësues.

Sipas shpjegimeve të menaxhmentit, kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme, dhe ndarjes jo të duhur të detyrave për shkak të stafit të reduktuar gjatë kohës së pandemisë.

Ndikimi

Mos respektimi i kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit mund të ndikojë që RTK të favorizoj operatorët dhe të eliminojë konkurrencën. Kurse, angazhimi i zyrtarëve të njëjtë në disa detyra në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit/kontratave paraqet ndarje jo adekuate të detyrave e cila mund të rris rrezikun për konflikt interesi.

Rekomandimi A13

Bordi i RTK-së të sigurojë se departamenti i prokurimit i zbaton me konsistencë të gjitha kërkesat e rregulloreve të prokurimit dhe do të eliminoj të gjitha lëshimet e identifikuara në rastet e identifikuara më lartë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen).

Çështja A14 - Procesimi jo i plotë i pasurive përmes softuerit të kontabilitetit

Gjetja

Bazuar në rregulloren e pasurisë jo financiare te RTK-së, neni 3 pika 1.9, RTK duhet të posedojë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive, duke përfshirë pasuritë kapitale, jo kapitale dhe stoqet, që do të azhurnohet vazhdimisht, e që do të përdoret edhe për raportimin e të dhënave në Pasqyra Financiare. Edhe neni 6, pika 3 e rregullores, përcakton që pasuria kapitale, jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në modulin për menaxhimin e pasurive. Kapitalet tjera janë në kuadër të klasifikimit të përgjithshëm të pasurive jo financiare të RTK-së.

Gjatë ekzaminimeve tona kemi vërejtur se vetëm moduli i pasurisë afatgjatë ishte i inkorporuar në softuerin e përdorur nga RTK. Te moduli i pasurisë së pa prekshme dhe moduli i deposë (stoqeve), evidencat kontabël mbaheshin në formatin Excel. Kjo bart rrezik të shtuar në menaxhimin e tyre, për shkak se sistemi është i qasshëm për çdo përdorues. Për më tepër, zyrtari i pasurisë nuk kishte qasje në këto dy module, gjë e cila shkakton vështirësi në grumbullimin e plotë të të dhënave dhe menaxhimit të pasurisë në RTK.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme si dhe rëndësisë së pamjaftueshme në procesimin e të dhënave përmes softuerit dhe gjenerimit të tyre të plotë në PFV.

Ndikimi

Mungesa e aplikimit të modulit gjithëpërfshirës në menaxhimin e pasurisë së RTK-së, dobëson mbrojtjen e duhur të pasurive nga rreziqet e tjetërsimit apo humbjes, e po ashtu edhe në prezantimin jo të saktë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A14

Bordi i RTK-së të sigurojë se menaxhimi i pasurisë së paprekshme dhe stoqeve të bëhet përmes një moduli të integruar, në të cilin zyrtari i pasurisë në çdo kohë ka qasje të plotë në të gjitha pasuritë dhe menaxhimin e tyre, si dhe gjendja e stoqeve të vendoset nën një kontroll më efikas.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të hyrat

Të hyrat e realizuara për vitin 2021 ishin në vlerë 12,895,186€. Prej tyre, nga Buxheti i Republikës së Kosovës ishin 11,200,000€ ndërsa nga të hyrat e realizuara prej RTK ishin 1,695,186€. Të hyrat e realizuara nga RTK kanë të bëjnë me të hyrat nga marketingu, kompensimet, grantet, vendosja e antenave, youtube dhe të hyrat e tjera. Për këto, kemi testuar 68 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 11,700,944€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A15 - Mos funksionimi i njësisë së monitorimit në marketing

Gjetja

Sipas nenit 32 të rregullores së marketingut, RTK i dorëzon klientit faturën për reklamën e porositur dhe të konfirmuar. Këtë konfirmim njësisë së faturimit ia bën njësia/softueri i monitorimit në marketing.

Nga testimi i 38 mostrave për të hyrat nga marketingu, në 13 prej tyre ka pasur korrigjime me shumë vonesë të faturave mbi shërbimet e kryera (zvogëlime të shumave në fatura). Te gjitha këto shërbime ishin të faturuara gjatë muajve të ndryshëm të vitit 2021, kurse 11 korrigjime të faturave në vlerë prej 2,789€ janë bërë gjatë muajit shkurt 2022 në të dhënët kontabël të të hyrave të vitit 2021, kurse 2 korrigjime në vlerë prej 2,366€ janë në të hyrat e vitit 2022. Rrjedhimisht kishte mbivlerësim të të hyrave të vitit 2021 për 2,366€.

Kjo ka ndodhur për shkak të problemeve të vazhdueshme me softuerin e monitorimit në marketing gjatë vitit 2021 dhe njësia e faturimit kishte marrë me vonesë informatën për atë që faturimi i bërë (transmetimi) nuk korrespondon me porosinë e klientit.

Ndikimi

Ndryshimi i shpeshtë i faturave për shkak të mos evidentimit të problemeve të njësisë së monitorimit në marketing, mund të ndikojë në mos evidentimin dhe raportimin e saktë të të hyrave, si dhe në ankesat e klientëve.

Rekomandimi A15

Bordi i RTK-së të sigurojë se do të merren veprime konkrete për evidentimin dhe rregullimin e problemeve tek njësia monitorimit në marketing, në mënyrë që ky softuer të përmirësohet dhe funksionalizohet plotësisht.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative ishin 3,214,426€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzimet e të drejtave programore, produksionet vendore dhe të jashtme, shtesa për emisione, pastaj komunalitë, tarifat e licencës, shpenzimet e zyrës dhe ato administrative, shpenzimet e qirasë së veturave, dhe të tjera. Në këto shpenzime, kemi testuar 62 mostra për teste substanciale në shumën 1,106,893€, si dhe 6 mostra të prokurimit për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A16 - Dobësi në raportim të progresit të kontratave nga menaxherët

Gjetja

Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik, kërkojnë që pas nënshkrimit të kontratës Zyrtari Kryesor Administrativ emëron një menaxher të projektit për menaxhimin e kontratës (paragrafi 61.4). Menaxheri i projektit harton një plan për menaxhimin e kontratës i cili dorëzohet tek departamenti i prokurimit (paragrafi 61.7, 61.8 dhe 61.9); dhe menaxheri i projektit harton dhe dorëzon raportin mbi progresin e një kontrate tek departamenti i prokurimit (paragrafi 61.20).

Në tri mostra kemi vërejtur se menaxherët e kontratave nuk kishin azhurnuar raportin e tyre sipas dinamikës së realizimit të kontratave. Raportet e tyre nuk ishin të sakta, por të njëjtit kishin raportuar shifra të përafërta për transmetimet e ndodhura të ndeshjeve apo emisioneve, dhe jo në mënyrë të saktë për volumin e transmetimeve deri në datën raportuese. Ky raportim ka reflektuar edhe tek saldot e fundvitit të cilat janë raportuar në pasqyra financiare dhe të cilat në disa raste nuk ishin të sakta si rezultat i mbikëqyrjes jo të duhur dhe të dhënave jo të azhurnuara nga menaxherët e kontratave.

Sipas shefit të prokurimit, kjo kishte ndodhur për arsye se stafi nuk është shumë i përgatitur për të vendosur aktivitetet e menaxhimit të kontratës në platformën elektronike.

Ndikimi

Kontrollet e dobëta në menaxhimin e kontratave mund të ndikojnë në mbipagesa për shumat e korrigjuara të faturave dhe në saktësinë e raportimit të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A16

Bordi i RTK-së duhet të siguroj se janë vendosur kontrolle adekuate sa i takon menaxhimit të kontratave, në mënyrë që raportimi i progresit të kontratave të jetë me kohë dhe i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur për të ofruar siguri objektive dhe një aktivitet këshillues, i dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e kompanisë.

Çështja A17 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Bazuar në ligjin nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, Komiteti i auditimit përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë, ku dy të tretat (2/3) janë të jashtëm nga fusha përkatëse e auditimit, ndërsa pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik. Komiteti i auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.

Komiteti i auditimit të brendshëm në RTK, nuk ishte sipas kërkesave të ligjit, pasi në përbërjen e tij nuk kishte dy të tretat e anëtarëve të jashtëm. Kjo për faktin, që anëtarët e komitetit të auditimit ishin zgjedhur prej Bordit bazuar në rregulloren e brendshme për punën e Bordit të RTK-së.

Më tej, Bordi i RTK-së ishte shkarkuar në fund të muajit qershor 2021 dhe që nga atëherë Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka qenë funksional për arsye se të gjithë anëtarët e këtij Komiteti janë njëherit edhe anëtarë të Bordit Drejtues.

Sipas zyrtarëve të RTK-së kjo situatë kishte ndodh nga mos harmonizimi i rregullores së punës së Bordit me kërkesat e ligjit për kontroll të brendshëm të financave publike.

Ndikimi

Mos harmonizimi i rregullores së punës së bordit me kërkesat e ligjit si dhe mungesa e një Komiteti efektiv të auditimit të brendshëm ka ndikuar në reduktimin si të nivelit të aktiviteteve të NJAB, po ashtu edhe në përkrahjen e saj në mbështetjen e zbatimit të rekomandimeve. Mungesa e Komitetit të Auditimit, po ashtu dobëson qeverisjen e përgjithshme në RTK, ngase ka mungesë të diskutimeve për adresimin e gjetjeve nga raportet e auditimit të brendshëm.

Rekomandimi A17

Bordi i RTK-së të siguroj së emërimi i anëtarëve të komitetit të auditimit të brendshëm duhet të ketë së paku dy të tretat e anëtarëve të jashtëm sipas kërkesave të Ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të Radio Televizionit të Kosovës nuk ka pasur asnjë rekomandim. Raporti i auditimit ishte kryer nga një kompani e jashtme e auditimit.

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit

Fejzullah Fejza, Udhëheqës i ekipit

Fisnik Rudaj, Anëtar i ekipit

Muhamet Balaj, Anëtar i ekipit

Shtojca I: Letër konfirmimi

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
27. 05. 2022

Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit	Klasifik. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr.i faqeve Br. Stranica No. Pages
05	47	841	1

RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0101/22
Data 27.05.2022
PRISHTINË

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do të ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Besnik Boletini

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS • RADIO TELEVISION OF KOSOVO • RADIO TELEVIZIJA KOSOVA

Kryetar i Bordit të **Radio Televizionit të Kosovës**

Data 27 maj, 2022

str. "Xhemajl Prishtina" no. 12, 10000 Prishtinë, Republic of Kosovo
tel. +381 38 230 102, fax. +381 38 235 336, www.rtklive.com
FN: 600294657, PCB 1110-012194-0001-59, SWIFT MBKORS22

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.

[2] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënimi	Më 31 Dhjetor, 2021 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor 2020 (në '000 Euro)
ASSETS			
Asetet jo qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	2,468	3,897
Asetet e paprekshme	5	1,578	1,902
		4,046	**5,799**
Asetet qarkulluese			
Stoqet		5	7
Investimet ne pjesëmarrje	6	1	1
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	449	275
Paraja në dorë dhe në banka	8	42	50
		496	**334**
GJITHSEJT ASETET		**4,542**	**6,133**
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti			
Kapitali themelues dhe rezervat	9	1,237	2,270
Fitimet e bartura		882	441
		2,119	**2,711**
Detyrimet jo-rrjedhëse			
Te hyrat e shtyra nga grantet		377	432
		377	**432**
Detyrimet rrjedhëse			
Llogarit e pagueshme dhe të tjera	10	1,553	2,614
Total llogaritë e pagueshme dhe tregtare		**1,553**	**2,614**
Detyrimet tjera afatshkurtra			
Huatë – afatshkurta			0
Tatime te pagueshme	11	142	136
Avanset nga klientet e marketingut		351	241
		493	**377**
TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET		**4,542**	**6,133**

Autorizuar për publikim nga ana e menaxhmentit dhe e nënshkruar në emër të tyre më 20 Mars, 2022

Ztr. Shkumbin Ahmetxhekaj	***Ztr. Halil Bajramaj***	***Ztr. Xheydet Leci***
UD Drejtor i Përgjithshëm	Zyrtar Kryesor Financiar	Kontabilist i Certifikuar

Shënimet e bashkangjitura prej 10 deri 33 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
Pasqyra e fitmit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

	Shënimi	Fund vitin 31 Dhjetor 2021 (në '000 Euro)	Fund vitin 31 Dhjetor 2020 (në '000 Euro)
TË HYRAT OPERATIVE			
Te hyrat nga Buxheti i Kosovës		11,200	11,200
Të hyrat nga marketingu	12	1,114	1,074
Të hyrat tjera	13	583	738
		12,897	**13,012**
SHPENZIMET OPERATIVE			
Zhvlerësimi	4	(452)	(475)
Amortizimi	5	(185)	(184)
Shpenzimet e stafit dhe bordit	14	(8,909)	(8,625)
Shpenzimet e programit dhe te tjera	15	(2,858)	(3,241)
Provizioni për borxhe të vjetra	7	(51)	(67)
		(12,456)	**(12,591)**
FITIMI / (HUMBJA) E VITIT		**441**	**421**
Te ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Zërat që nuk I takojnë fitimit ose humbjes se vitit			
Lirimi nga rivlerësimi i pasurisë		115	
Shlyerja e rezervave rivleresuese		(1,148)	
Te hyra tjera gjithëpërfshirëse		**(1,033)**	
TOTAL TË HYRA GJITHËPËRFSHIRËSE		**(592)**	**421**

Shënimet e bashkangjitura prej 10 deri 33 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet

	Kapitali dhe rezervat	Fitimet e mbajtura	TOTALI
	----------(në '000 Euro)----------		
Gjendja me 1 Janar, 2021			
Korrigjimi i humbjeve te mbajtura	**2270**	**441**	**2711**
Fitimi (humbja) e vitit		441	**441**
Te hyra gjithëpërfshirëse tjera	(1033)		**(1033)**
Total te hyra gjithëpërfshirëse	**(1033)**	**441**	**(592)**
Gjendja me 31 Dhjetor, 2021	**1237**	**882**	**2119**
Gjendja me 1 Janar, 2020	**2,270**	**20**	**2,290**
Korrigjimi për asete te gjetura			
Fitimi (humbja) e vitit		**421**	**421**
Te hyra gjithëpërfshirëse tjera			
Total te hyra gjithëpërfshirëse		**421**	**421**
Gjendja me 31 Dhjetor, 2020	**2,270**	**441**	**2,711**

Shënimet e bashkangjitura prej 10 deri 33 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimi	Fund vitin 31 Dhjetor 2021 (në '000 Euro)	Fund vitin 31 Dhjetor 2020 (në '000 Euro)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Suficiti / Deficiti neto		441	421
Korrigjimet për zërat jo-ne para:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4&5	637	658
Te hyrat nga grantet		(74)	(86)
Vlera neto e aseteve te paprekshme te njohura shpenzime		737	96
Vlera neto e aseteve te shlyera	4	126	
Deficiti operativ para ndryshimeve në asetet dhe detyrimet operative		1,867	1,089
(Rritja) / zvogëlimi I e stoqeve		2	6
Zvogëlimi/ (Rritja) në llogaritë e arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(174)	9
(Zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme dhe të tjera		(945)	(262)
Paraja e gjeneruar nga/(e përdorur në) aktivitetet operative		**750**	**836**
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	4	(182)	(233)
Blerja e aseteve të paprekshme	5	(597)	(204)
Paraja e përdorur në aktivitetet investive		(779)	(437)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:			
Grantet e pranuara gjatë vitit		21	
Kreditë e pranuar/(paguara) gjatë vitit			(389)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		**21**	**(389)**
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të parasë		**(8)**	**10**
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		**50**	**40**
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		**42**	**50**

Shënimet e bashkangjitura prej 10 deri 33 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Radio Televizioni i Kosovës është institucion publik me rendësi të posaçme kulturore dhe kombëtare, i cili ofron shërbim publik në fushën e veprimtarisë së radios dhe televizionit, e themeluar në përputhje me Rregulloren Nr. 2001/13 te UNMIK-ut, për themelimin e Radio Televizionit të Kosovës, e datës 15 Qershor 2001.
Themelues i RTK-ës si institucion publik është Kuvendi i Kosovës. Kuvendi i Kosovës mbron autonomin institucionale dhe pavarësinë editoriale si dhe te siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-ës. Me qëllim të sigurimit të funksionit të plotë në nivel profesional të RTK-ës themeluesi po ashtu garanton sigurimin e objekteve të përshtatshme punuese. Veprimtarinë e ka të përcaktuar me Ligjin për RTK-ën Nr.04/L-046 te datës 29 Mars 2012

Entiteti është me bazë në Prishtinë, Kosovë dhe siguron shërbimin e transmetimit në gjithë rajonin e Kosovës duke u udhëhequr nga parimet e një Transmetuesi Publik, në përputhje me Kreu II. Neni 3 ; Ligji për RTK-ën Nr. 04/L-046 te datës 29 Mars 2014
Sipas Nenit 8, RTK përfshinë dy (2) kanale televizive (kanali televiziv ne gjuhen shqipe dhe kanali televiziv ne gjuhen serbe) dhe dy (2) kanale të radios të Kosovës. Këto dy (2) kanale janë të detyruara te ndajnë 15% të skemës se tyre programore për gjuhet e komuniteteve tjera të Kosovës.
Entiteti aktualisht vepron me katër kanale te televizionit dhe dy radio, të gjitha të vendosura në Prishtine.

Financimin e RTK-es e rregullon Ligji për RTK-ën Nr. 04/L-046; Kreu IV Neni 21.
Për një periudhë transitore deri trevjeçare , deri ne sigurimin e financimit nga parapagimi, çdo vit RTK-ës do ti ndahen 0.7% e te hyrave nga Buxheti i Kosovës (duke përjashtuar te hyrat ne Buxhetin e Kosovës nga Privatizimi, te hyrat e njëhershme dhe te hyrat vetanake nga niveli qendror dhe ai lokal), 10 % e buxhetit total te RTK-se i ndahet televizionit ne gjuhën serbe.
Organi drejtues i RTK-ës do të jetë Bordi i RTK-ës i përbërë prej 11 anëtareve të cilët janë të emëruar nga Kuvendi i Kosovës.(Kapitulli V Neni 24 paragrafi 1.1
Bordi i RTK-ës punon dhe vepron ne përputhje me dispozitat e ligjit dhe statutin e RTK-ës,

Numri i punonjësve në entitet me 31 Dhjetor 2021 ishte 774 duke përfshi të punësuarit e rregullt 758 punëtorë, menaxhmenti i larte 7 , bordi 9 anëtar, si dhe gjatë vitit ka pas te angazhuar me kontrata si punëtor sekondare, 258 te punësuar si: aktor, këngëtar, gazetar ne Kosovë dhe korrespodent jashtë shteti

2. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara të Raportimit Financiar Ndërkombetarë

Kompania ka miratuar të gjitha standardet e reja apo të amandamentuara Kontabël dhe Interpretimet të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të obligueshme për periudhën e tanishme raportuese. Çdo Standard apo Interpretim i ri apo i amandamentuar që nuk është ende i obligueshëm nuk është adoptuar.

Organizata ka zbatuar standardet dhe ndryshimet e mëposhtme për herë të parë për periudhën e raportimit duke filluar nga 1 janari 2021:

- Ndryshimet SNRF 4 Zgjerimi i Përjashtimit të Përkohshëm nga Zbatimi i SNRF 9
- SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4, SNRF 16 Reforma standarde e normës së interesit - Faza 2
- SNRF 16 Koncesionet e qirave të lidhura me Covid-19 përtej 30 qershorit 2021

Ndryshimet e listuara më sipër nuk patën ndonjë ndikim në shumat e njohura në periudhat e mëparshme dhe nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në periudhat aktuale ose ato të ardhshme.

Standardet e reja dhe të rishikuara të SNRF të lëshuara, por ende jo efektive

Janë lëshuar disa standarde dhe interpretime të reja të kontabilitetit që nuk janë të detyrueshme për periudhat e raportimit me 31 dhjetor 2021 dhe nuk janë miratuar herët nga Organizata. Këto standarde nuk pritet të kenë një ndikim material në njësinë ekonomike në periudhat aktuale ose të ardhshme të raportimit dhe mbi transaksionet e parashikueshme në të ardhmen.

- SNRF 17 (përfshirë ndryshimet e qershorit 2020 në SNRF 17) Kontratat e sigurimit
- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët
- Ndryshime në SNK 1 Klasifikimi i pasiveve si afatshkurtra ose afatgjata
- Ndryshime në SNRF 3 Referenca në Kuadrin Konceptual
- Ndryshimet në SNK 16 Aktivet afatgjata materiale - Të ardhurat përpara përdorimit të synuar
- Ndryshimet në SNK 37 Kontratat e veshtira—Kostoja e përmbushjes së një kontrate
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF 2018-2020 Ndryshimet e ciklit të SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNRF 16 Qiratë dhe SNK 41 Bujqësia
- Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e praktikës SNRF 2 Shpalosja e politikave kontabël
- Ndryshime në SNK 8 Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël
- Ndryshimet në SNK 12 Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm

Menaxhmenti nuk pret që adoptimi i Standardeve të listuara më sipër do të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të organizatës në periudhat e ardhshme.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

3.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS").

3.2 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike përveç rastit të rivlerësimit të disa aseteve dhe detyrimeve financiare, siç është shpjeguar më poshtë në politikat e kontabilitetit.
Kostoja historike është e bazuar në përgjithësi në shumën e dhëne në këmbim të pasurisë.
Këto janë pasqyra financiare individuale te organizatës qe synojnë te përdoren kryesisht për përmbushjen e raportimeve statutore. Organizata duhet te përgatisë pasqyrat financiare te konsoliduara, te cilat nuk janë ne dispozicion e datën e këtij raporti. Këto pasqyra financiare individuale munde te mos jen te përshtatshme për t'u përdorur për qëllime te përgjithshme nëse nuk lexohen se bashku me Pasqyrat Financiare te Konsoliduara.

3.3 Parimi i vazhdueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdueshmërisë. Operacionet e Kompanisë financohen nga buxheti i Kosovës duke siguruar kështu një vazhdimësi te operacioneve se paku edhe ne 12 Muajt e ardhshëm.

3.4 Valuta e prezantimit

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euroja (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euroja ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

3.5 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj përveç Euros regjistrohen sipas kursit të këmbimit në fuqi në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit si rezultat i zgjidhjes së transaksioneve në valutë të huaj përveç Euros përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit i cili është në fuqi në atë datë.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT(VAZHDIM)

Pasuritë dhe detyrimet monetare të shndërruara në valuta tjera përveç Euros kthehen në Euro sipas kursit mesatar të këmbimit në treg në datën e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet në valuta të huaja që ndodhin për shkak të këmbimit të aseteve dhe detyrimeve reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si diference ndërmjet fitimeve dhe humbjeve për shkak të shndërrimit të kursit të këmbimit

3.6 Prona, impiantet dhe pajisjet

Artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve deklarohen sipas kostos së vlerësuar minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi.

Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që mundë te këtë përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin të cilat do rrjedhin për Kompaninë dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet ngarkohen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën ato kanë ndodhur.

Zhvlerësimi në asetet llogaritet duke përdorur metodën e saldos zbritëse për të shpërndarë koston e tyre në vlerën e tyre të mbetur gjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit siç vijon:

Pajisjet TV, Radio	10 vite
Pajisjet kompjuterike	5 vite
Mobilje dhe orendi	10 vite
Mjete transportuese dhe inventar ekonomik	10 vite

Vlera e mbetur e aseteve dhe koha e përdorimit rishikohet, dhe korrigjohet nëse është nevoja, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e asetit shlyhet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera e bartur e asetit është më e madhe se shuma e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga largimi nga përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

3.7 Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga serialet dhe te drejtat televizive te blera. Këto fillimisht maten sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluara të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën lineare sipas përqindjeve ne vijim:

	Transmetimi i I	Transmetimi i II	Transmetimi i III / vlere e mbetur
Kosto e zhvillimit të serialit	60%	30%	10%

Menaxhmenti i Kompanisë ka vendosur te ndryshoj politiken Kontabël për amortizimin e aseteve te paprekshme ne vitin 2020 duke kaluar nga metoda e saldos zbritëse ne metodën lineare. Pas parasysh qe ky ndryshim është bere me qellim te përshtatjes se shpenzimeve te amortizimit dhe prezantimit te një vlere me reale te pasurive te paprekshme, te gjitha ndryshimet janë aplikuar retrospektivisht dhe pasqyrat financiare janë ri deklaruar. Menaxhmenti po ashtu ka ndryshuar edhe vlerësimin mbi normat e amortizimit.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.8 Dëmtimi i aseteve jo-financiare

Asetet që kanë kohë të pakufizuar të përdorimit nuk i nënshtrohen përdorimit dhe testohen në baza vjetore për dëmtim. Asetet të cilat i nënshtrohen amortizimit rishikohen për dëmtim kurdoherë kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera e bartur mund të mos jetë e rikuperueshme. Humbja nga dëmtimi njihet për shumën me të cilën vlera e bartur e asetit e tejkalon shumën e rikuperueshme të atij aseti. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës reale të asetit minus kostoja e shitjes dhe vlera në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të dëmtimit, asetet grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë rrjedha të identifikueshme të veçanta të parave (njësi që gjenerojnë para). Asetet jo-financiare që kanë pësuar dëmtime rishikohen për rikthime të mundshme të dëmtimit në secilën datë raportuese.

3.9 Asetet dhe detyrimet financiare

Kompania klasifikon investimet e saj në kategoritë e mëposhtme: asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, huave dhe llogarive të arkëtueshme, të mbajtura deri në maturim asetet financiare dhe asetet në dispozicion për shitje financiare. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilën investimet janë të fituara. Menaxhimi i përcakton klasifikimin e investimeve të saj në njohjen fillestare dhe rivlerëson këtë në çdo datë raportimi.

a) Asetet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes
Kjo kategori ka dy nën-kategori: asetet financiare të mbajtura për tregtim dhe atyre të përcaktuar në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në fillim. Një aset financiar klasifikohet ne kategorinë e "aseteve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes" në fillim nëse është përfituar kryesisht për qëllim të shitjes në afat të shkurtër, nëse ajo është pjesë e një portofoli të aseteve financiare në të cilat ka prova afatshkurtër fitim-marrjen, ose në qoftë se kështu i caktuar nga Menaxhmenti. Kompania nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori.

b) Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme
